

P.nr.2618/2016

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit P: K, nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.177-2/2016 të datës 30.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Elfete Purova, dhe të akuzuarit, me date 12.10.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

#### I akuzuari:

P. K, nga i ati Sh dhe nëna Xh e lindur K, i lindur me datë , në Prizren, ku edhe tani jeton, në rrugën nr. , ka të kryer shkollën e mesme, teknik i dhëmbëve, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomi, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Se me datë 22.11.2015, rreth orës 18,00 në Prizren, në rrugën , nr. në shtëpinë e të dëmtuarit G. J, personit tjetër ia merr pasurinë me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e vulltshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, hyn në oborrin e shtëpisë, dhe nga aty merr 1 (një) biçikletë të markës "Aroe", në vlerë prej 1.200 (njëmijë e dyqind) euro dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me ç' rast të dëmtuarit i shkakton dëm material,

Këso dore ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KP-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe nenit 325 par.1 të KP-ës, te akuzuarit ia shqipton:

### DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë te re penale, dhe

### DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 (treqind) Euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 15 ditë burg.



Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.177/2016 të datës 30.11.2016, kundër të akuzuarit P K , nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 te KP-ës,

Prokurori i shtetit Musli Gashi, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se i akuzuari, ditën kritike në shtëpinë e të dëmtuarit G J kishte marrë biçikletën cilën me njoftimin përmes rrjetit social facebook se është e G por të njëjtën nuk ja kthen derisa në Prizren njoftohet përmes të njëjtit se për rastin në fjalë janë njoftuar organet e rendin dhe me datë 27.01.2016 në deklaratën në polici i konfiskohet biçikleta të cilën më pas organet ja kthejnë të dëmtuarit.

Po ashtu ditën kritike i akuzuari shpreh keq ardhjen ne veprimet e tija dhe i kërkon falje të dëmtuarit. Ndërsa pretendimet se të njëjtën e ka blerë në Prishtinë njëherë me çmim prej 150 euro e më vonë për 50 euro, i vetë di shëm se biçikleta është e shtrenjtë ashtu siç deklaron vet në fjalën mbrojtëse janë të pajustificueshme dhe të pa bazuara në prova. Po ashtu në pyetjen të prokurorit e shtetit se ku ishte në ditën kritike kur ka ndodhur rasti i njëjti nuk u përgjigje duke mos specifikuar asgjë.


Andaj konsiderojmë se është e pa justifikueshme se biçikleta është e të dëmtuarit, kjo rezulton edhe nga vet i akuzuari, andaj gjendja faktike e konstatuar në dispozitiv të aktakuzës është të bazuar drejt se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë të gjitha elementet të veprës penale të cilën e ngarkon aktakuza, prandaj propozoj gjyqtarit gjykues që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave, të marr vendim meritor sipas ligjit.

I dëmtuari G J , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: unë edhe gjatë deklaratës sime, edhe tani deklaroj që nuk e ndiej veten të dëmtuar, pasi që biçikleta më është kthyer, e njëjta më është kthyer në gjendje siç ka qenë, nuk ka qenë e dëmtuar, andaj konkretisht nuk e di vetën të dëmtuar, dhe nuk parashtroj kërkesë pronësoro juridike.

I akuzuari P K , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: unë edhe në shqyrtimin fillestar, edhe tani në fjalën përfundimtare, si në fjalën hyrëse, edhe gjatë mbrojtës sime, edhe tani përfundimisht deklaroj që nuk e ndiej veten fajtor për veprën penale e cila më vihet në barë, e po ashtu deklaroj që e ndiej veten fajtor vetëm prej momentit kur kam kuptuar që biçikleta që unë e kam blerë në Prishtinë, është e këtu të dëmtuarit, andaj konsideroj që unë personalisht nuk e kam marr nga i akuzuari, por të njëjtën e kam blerë në Prishtinë.

Në fund i propozoj gjykatës që të më liroj nga kjo akuzë.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:



Se me datë 22.11.2015, rreth orës 18,00 në Prizren, në rrugën " " , nr. " " , i akuzuari në shtëpinë e të dëmtuarit G " " J " " , personit tjetër ia merr pasurinë me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, hyn në oborrin e shtëpisë, dhe nga aty merr 1 (një) biçikletë të markës "Aroe", në vlerë prej 1.200 (njëmijë e dyqind) euro dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me ç' rast të dëmtuarit i shkakton dëm material,

Gjykata pas vlerësimit të gjitha shkresave dhe provave të lëndës dhe ate: deklaratës të dëmtuarit, të akuzuarit si dhe provave materiale dhe ate deklarata e të dëmtuarit G " " J " " e dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 22.11.2015, dhe me datë 27.01.2016, deklarata e të pandehurit P. " " K " " e dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 27.01.2016, vërtetimin mbi konfiskimin e gjësendeve të datës 27.01.2016, vërtetimi mbi kthimin e gjësendeve të datës 27.01.2016 si dhe foto dokumentacioni, si dhe si dhe shkresave tjera përcjellëse të lëndës, ka ardhur në përfundim se i akuzuari P. " " K " " , në Prizren, me datë 22.11.2015, rreth orës 18:00 minuta, në rrugën " " , nr. " " , në shtëpinë e të dëmtuarit G " " J " " , hynë në oborrin e shtëpisë dhe nga aty merr 1 (një) biçikletë, të markës "Aron", në vlerë prej 1200 (një mijë e dyqind) euro dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me të cilin rast të dëmtuarit i shkakton dëm material, dhe këtë e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe ka dëshiruar kryerjen e saj. Pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësin e tij penal juridike, nga kjo del që në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KP-ës.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga deklarata e të dëmtuarit G " " J " " i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.10.2017 deklaronë kam vërejtur që nuk e kam biçikletën brenda ditës. deri me datën 22.11.2015, biçikletën e kam pasur në pronësi. Biçikletën e kam gjetur pasi që më ka njoftuar P " " që biçikletën time e ka blerë diku tjetër, por nuk e kam ditur që është e jotja; nuk kam kërkuar ndonjë kompensim për biçikletë, diku pas një jave pasi që më është vjedhur biçikleta kam biseduar me këtu të akuzuarin për biçikletën, unë e kam paraqitur rastin në polici.

Diku para 10 viteve para rastit të ndodhur. e kam njoftuar të akuzuarin P. " " . Raportet tona kanë qenë të mira. I akuzuari P. " " e ka ditur që unë posedoj biçikletën e markës "Aroe" në vlerë prej 1.200 euro. e ka ditur krejt Prizreni. kam qenë i dëmtuar fillimisht, por pasi që më është kthyer biçikleta, nuk e ndiej veten të dëmtuar. nuk parashtroj kërkesë pronësoro juridike. Rastin në polici e kam paraqitur në ditën kritike.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.10.2017, janë administruar provat materiale dhe ate deklarata e të dëmtuarit G " " J " " e dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 22.11.2015, dhe me datë 27.01.2016, deklarata e të pandehurit Pashtrik Krusha e dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 27.01.2016, vërtetimin mbi konfiskimin e gjësendeve të datës 27.01.2016, vërtetimi mbi kthimin e gjësendeve të datës 27.01.2016 si dhe foto dokumentacioni,

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.10.2017, i akuzuari P " " K " " deklaron: unë biçikletën e kam blerë në tregun e automjeteve në Prishtinë, nuk e kam ditur që e njëjta është e vjedhur, ngase po ta kisha ditur nuk do ta kisha blerë kur. Biçikletën e kam paguar 150 euro Në



polici në deklaratën e të datës 27.01.2016, kam deklaruar 150 euro, e pse është shënuar 50 euro këtë nuk e di. Nuk më kujtohet koha kur e kam blerë biçikletën


Po është e vërtet që në deklaratën e dhënë në Stacionin policor me datë 27.01.2016, kam deklaruar që biçikletën e kam blerë një muaj e gjysë më herët, jo nuk më kujtohet. ku kam qenë me datë 22.11.2015. Në dijeni që biçikleta është e G. kam ardhur kur e kam parë në rrjetin social facebook. Kur e kam kuptuar që biçikleta është të dëmtuarit, fillimisht e kam dërguar në Stacionin policor në Prizren, dhe pasi që i njoftova zyrtarët policor që biçikleta është e këtu të dëmtuarit, të njëjtit më udhëzuan që të shkoj vet ti dorëzoj, dhe unë i ja ktheva të dëmtuarit.

Nuk kam nënshkruar ndonjë dokument kur ja kam kthyer biçikletën e të dëmtuarit, dokument është këtu i dëmtuari. Po, nënshkrimi është i imi në këndin e majtë të poshtëm në vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve, të datës 27.01.2016.

Para datës kritike kam jetuar jashtë Prizrenit, një vite e gjysëm jashtë Prizrenit, dhe ate në Pejë. Më vjen keq për veprimin tim, dhe i kërkoj falje këtu të dëmtuarit G. J., ngase këtu të dëmtuarin e njoh që 15 vite dhe të njëjtin e kam shok. Edhe pse e kam shok të dëmtuarin, nuk e kam ditur që i njëjti posedon biçikletë të markës "Aroe" në vlerë prej 1.200 euro, unë faktikisht e kam ditur që G. ka biçikletë, por markën dhe llojin dhe vlerën kaq të madhe të saj nuk e kam ditur. Po e kam parë, para rastit biçikletën e të dëmtuarit. Në momentin dhe kohën kur e kam blerë, në treg të automjeteve në Prishtinë, nuk e kam vërejtur këtë fakt, që e njëjta është identike me ate të dëmtuarit – shokut tim G. Në momentin kur e kam blerë biçikletën në vlerë prej 150 euro, e kam ditur që nuk është çmim adekuat shuma prej 150 euro, më është dukur shumë lirë, andaj edhe kam blerë. Pasi që ja ktheve biçikletën të dëmtuarit G., nuk i kërkoja kompensimin prej 150 euro, aq sa e kisha blerë unë paraprakisht, nuk i kam kërkuar pasi që është në pyetje shoku im G. J.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të dëmtuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ku deklaroi se i njëjti e ka vërejtur që nuk e ka biçikletën brenda ditës. deri me datën 22.11.2015, biçikletën e ka pasur në pronësi. Biçikletën e ka gjetur pasi që e ka njoftuar P. që biçikletën time e ka blerë diku tjetër, por nuk e ka ditur që është e tij, nuk ka kërkuar ndonjë kompensim për biçikletë, diku pas një jave pasi që i është vjedhur biçikleta ka biseduar me këtu të akuzuarin për biçikletën, i dëmtuari e ka paraqitur rastin në polici. Diku para 10 viteve para rastit të ndodhur. e kam njoftuar të akuzuarin P. Raportet e tyre kanë qenë të mira. I akuzuari P. e ka ditur që ai posedon biçikletën e markës "Aroe" në vlerë prej 1.200 euro. e ka ditur krejt Prizreni. ka qenë i dëmtuar fillimisht, por pasi që i është kthyer biçikleta, nuk e ndien veten të dëmtuar, nuk parashtron kërkesë pronësoresh juridike. Rastin në polici e kam paraqitur në ditën kritike.


Të cekurat më lartë vërtetohen edhe nga provat materiale të administruar në shqyrtimin gjyqësor dhe ate deklarata e të dëmtuarit G. J. e dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 22.11.2015, dhe me datë 27.01.2016, deklarata e të pandehurit P. e dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 27.01.2016, vërtetimin mbi konfiskimin e gjëseneve të datës 27.01.2016, vërtetimi mbi kthimin e gjëseneve të datës 27.01.2016 si dhe foto dokumentacioni,



Gjykata deklaratës të dëmtuarit, se fillimisht i është vjedhur biçikleta, dhe ate e markës “Aroe”, në vlerë prej 1200 euro, dhe pas një jave pasi që i është vjedhur biçikleta, ka biseduar me këtu të akuzuarin, i cili e ka njoftuar që biçikletën e cila është e tij, të njëjtën e ka blerë, por nuk e ka ditur që është e tij, andaj biçikleta i është kthyer të dëmtuarit, dhe pasi që i është kthyer nuk e ndien veten të dëmtuar, kësaj deklarate të dëmtuarit, gjykata në tërësi ja fali besimin, ngase e njëjta është e provuar dhe në përputhje të plotë edhe me provat tjera materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ate deklarata e të dëmtuarit G. J. e dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 22.11.2015, dhe me datë 27.01.2016, deklarata e të pandehurit P. K. e dhënë në Stacionin policor në Prizren me datë 27.01.2016, vërtetimin mbi konfiskimin e gjësendeve të datës 27.01.2016, vërtetimi mbi kthimin e gjësendeve të datës 27.01.2016 si dhe foto dokumentacioni, për çka gjykata në mënyrë të plotë ja ka falur besimin kësaj deklaratave dhe provave të cekura materiale të administruara të cilat si tërësi vërtetojnë edhe gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës

Në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari P. K., në mbrojtjen e deklaron që biçikletën e ka blerë në tregun e automjeteve në Prishtinë, nuk e ka ditur që e njëjta është e vjedhur, ngase po ta kishte ditur nuk do ta kishte blerë kur. Biçikletën e ka paguar 150 euro. Në polici në deklaratën e datës 27.01.2016, ka deklaruar fillimisht 50 euro, e në ballafaqimin me deklaratën e njëjtë, i njëjti thekson se edhe në polici ka thënë se ka paguar 150 Euro, për biçikletën, por pse është shënuar 50 euro këtë nuk e di. Nuk i kujtohet koha kur e ka blerë biçikletën. Në dijëni që biçikleta është e G. ka ardhur kur e ka parë në rrjetin social facebook. Kur e ka kuptuar që biçikleta është të dëmtuarit, fillimisht e ka dërguar në Stacionin policor në Prizren, dhe pasi që i njoftoi zyrtarët policor që biçikleta është e këtu të dëmtuarit, të njëjtit e udhëzuan që të shkoj vet ti dorëzoj, dhe i akuzuari i ja ktheu të dëmtuarit. Nuk ka nënshkruar ndonjë dokument kur ja ka kthyer biçikletën e të dëmtuarit, dokument është këtu i dëmtuari. Para datës kritike ka jetuar jashtë Prizrenit, një vite e gjysmë jashtë Prizrenit, dhe ate në Pejë. i vjen keq për veprimin e tij, dhe i kërkon falje këtu të dëmtuarit G. J., ngase këtu të dëmtuarin e njeh qe 15 vite dhe të njëjtin e ka shok. Edhe pse e ka shok të dëmtuarin, nuk e ka ditur që i njëjti posedon biçikletë të markës “Aroe” në vlerë prej 1.200 euro, faktikisht e ka ditur që G. ka biçikletë, por markën dhe llojin dhe vlerën kaq të madhe të saj nuk e ka ditur. E ka parë, para rastit biçikletën e të dëmtuarit. Në momentin dhe kohën kur e ka blerë, në treg të automjeteve në Prishtinë, nuk e ka vërejtur këtë fakt, që e njëjta është identike me ate të dëmtuarit – shokut të tij G. . Në momentin kur e ka blerë biçikletën në vlerë prej 150 euro, e ka ditur që nuk është çmim adekuat shuma prej 150 euro, i është dukur shumë lirë, andaj edhe e ka blerë. Pasi që ja ktheu biçikletën të dëmtuarit G., nuk i kërkoj kompensimin prej 150 euro, aq sa e kishte blerë ai paraprakisht, nuk i ka kërkuar pasi që është në pyetje shoku i tij G. J.

Kësaj deklaratë, gjykata nuk ja fali fare besimin, ngase e njëjta është shumë kundërthënëse, e paqartë dhe më shumë është e orientuar në mohimin e veprës penale, për të cilën deklaratë i akuzuari nuk arriti gjatë tërë shqyrtimit të provoj me ndonjë provë deklaratën e vet shfajësuese, kjo deklaratë më shumë ka për qëllim vetëm shmangien dhe përjashtimin e përgjegjësisë nga përgjegjësia penale e të akuzuarit dhe lirimin e të njëjtit nga akuza, e aq më parë që i akuzuari gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor është munduar me deklaratë të tillë të paqartë, të pabazuar në asnjë provë dhe fakt lidhur me vërtetimin e deklaratës së tij kundërthënëse e cila deklaratë ishte plotësisht në kundërshtim me provat tjera të administruara të cilave gjykata në tërësi ju fali besimin lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar, pas administrimit të të cilave prova



dhe vlerësimit të njëjtave, secilës veç e veç si dhe të gjithave si tersi, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale, të cilat elemente si tërësi përbëjnë figurën e veprës penale dhe ate të vjedhjes, andaj edhe vendosi që të akuzuarin të shpalli fajtor dhe të dënoj sipas ligjit, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësin e tij penalo juridike,

Nga të cekurat gjykata ka ardhur në përfundim që është e vërtet që i akuzuari ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshëm pasurinë e të dëmtuarit, dhe ate biçikletën, të cilin veprim i akuzuari gjatë mbrojtjes së vet ka tentuar ta arsyetoj që të njëjtën e ka blerë dhe pas njoftimit nëpërmes rrjetit social me të kuptuar që e njëjta qenka e të dëmtuarit, të njëjtën ja ka kthyer të dëmtuarit, kjo deklaratë sipas konstatimit të gjykatës është mjaft e zbehtë, kundërthënëse dhe e pabazuar në asnjë fakt apo provë tjetër, andaj në këtë mënyrë gjykata edhe ka vërtetuar që i akuzuari këtë veprim e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta, andaj gjykata ka ardhur në përfundim që në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit duke vërtetuar përgjegjësin e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese komform nenit 74 të KP-së, gjykata morri si rrethana lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e saj pas konfliktit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe dënim gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro duke menduar se dënimi-i-shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.2618/2016 me datë 12.10.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**

**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**



**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.